



**BASHKIA
TIRANË**
KRYETARI

Nr. prot. 14858

Tiranë më 14.5 2016

Drejtuar: Z. Aldrin Dalipi
Kryetar
Këshilli Bashkiak i Tiranës

Lënda: Dërgohet projekt - vendim dhe relacion për shqyrtim dhe miratim

I nderuar z. Dalipi,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim projekt vendimin dhe relacionin për "Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve dhe Klubit Sportiv "Tirana".

Ju urojmë punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR



Erion Veliaj





KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

VENDIM (projekt)

Nr. _____, datë _____ 2016

për

“Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve dhe Klubit Sportiv “Tirana”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 dhe nenit 54 pika ç të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë; ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” (i ndryshuar); pikës 17 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”; nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); Vendimit e Këshillit Bashkiak nr.7, datë 30.03.2009, për “Riorganizimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të disa ndërmarrjeve të varësisë së Bashkisë së Tiranës, për përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sportistëve të nivelit të lartë, si dhe mbi përdorimin e fondit rezervë” (i ndryshuar); vendimit e Këshillit Bashkiak nr.50, datë 20.11.2012 për “Riorganizimin e strukturës organizative, miratimin e rregullores dhe ndryshimin e nivelit të pagave të Klubit Sportiv “Tirana” ,vendimit nr.51, datë 11.11.2015 për “Disa ndryshime në nivelin e pagave të institucioneve të varësisë”, vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.58, datë 30.12.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit e Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve sipas lidhjes nr.5 bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit e Klubit Sportiv ‘Tirana’ sipas lidhjes nr.7 bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Maj të vitit 2016 dhe do të përballohen nga buxheti i këtyre institucioneve për vitin 2016.
4. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve dhe Klubi Sportiv ‘Tirana’

5. Lidhja e pagave e përcaktuar sipas lidhjes nr.7/1, në pikën nr.1 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.50, datë 20.11.2012 për “Riorganizimin e strukturës organizative, miratimin e rregullores dhe ndryshimin e nivelit të pagave të Klubit Sportiv “Tirana”, si dhe pika 2. shkronja “d” e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.7, datë 30.03.2009, për “Riorganizimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të disa ndërmarrjeve të varësisë së Bashkisë së Tiranës, për përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sportistëve të nivelit të lartë, si dhe mbi përdorimin e fondit rezervë” (i ndryshuar) revokohen.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

Aldrin Dalipi

Lidhja Nr.5

Niveli i pagave për punonjësit e Qendrës Ekonomike të Zhvillimit & Edukimit të Fëmijëve

Nr.	Pozicioni	Kategoria	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion
			1	2	3
1	Drejtor i Përgjithshëm	II-a	1	2%	105 000
2	Drejtor	II-b	1	2%	80 000
3	Pergjegjes sektori	III-a	1	2%	55 000
4	Pergjegjes sektori	III-a/1	1	2%	52 000
5	Specialist I	IV-a	1/2/3	2%	35 000
6	Specialist II	IV-b	1/2/3	2%	31 000
7	Pergjegjes çerdheje	IV-c	1/2/3/4	2%	30 000
8	Kujdestare	IV-c/1	1/2/3/4/5	2%	25 000
9	Specialist i mesem, furnitor, magazinier	IV-c/1	4	2%	25 000
10	Kuzhinierë	IV-c/2	4/5	2%	23 000
11	Shofer				30 000
12	Nd/kuzhinierë ,sanitare, pastrues, punëtor magazine				28 000
13	Roje				26 000

Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.5 të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË E TË MESËM E TETEVJEÇAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e arsimit të lartë:	
1	Master i Shkencave Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë
4	Diplomë e arsimit të mesëm	8 000 lekë
5	Diplomë e arsimit tetëvjeçar	6 000 lekë


Niveli i pagave për punonjësit e Klubit Sportiv "Tirana"

Nr.	Pozicioni	Paga individuale			Paga mujore
		Kategoria	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion
			1	2	3
1	Drejtor Klubi	II-b	1	2%	80 000
2	Trainer	III-b	1/2	2%	47 000
3	Pergjegjes i Zyrës së Financës	IV-a	1/2/3	2%	37 000
4	Specialist,Llogaritar-arkëtar	IV-b	1/2/3	2%	34 000
5	Masazhator	IV-b	1/2/3/4	2%	34 000
6	Pergjegjes terrenesh	IV-c	4	2%	28 000
7	Shofer, magazinier				34 000
8	Punëtor terrenesh				30 000

Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr. 7 të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË E TË MESËM

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e arsimit të lartë:	
1	Master i Shkencave Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë
4	Diplomë e arsimit të mesëm	8 000 lekë



BASHKIA
TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHMË E MENAXHIMIT FINANCIAR

RELACION për

“Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve dhe Klubit Sportiv “Trana”

Në mbështetje nenit 8 pika 2 dhe nenit 54 pika ç të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë; ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” (i ndryshuar); pikës 17 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”; nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); Vendimit e Këshillit Bashkiak nr.7, datë 30.03.2009, për “Riorganizimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të disa ndërmarrjeve të varësisë së Bashkisë së Tiranës, për përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sportistëve të nivelit të lartë, si dhe mbi përdorimin e fondit rezervë” (i ndryshuar); vendimit e Këshillit Bashkiak nr.50, datë 20.11.2012 për “Riorganizimin e strukturës organizative, miratimin e rregullores dhe ndryshimin e nivelit të pagave të Klubit Sportiv “Tirana” ,vendimit nr.51, datë 11.11.2015 për “Disa ndryshime në nivelin e pagave të institucioneve të varësisë”, vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.58, datë 30.12.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”, propozojmë përpara jush për miratim lidhjet e pagave për punonjësit e Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve si dhe të Klubit Sportiv “Tirana” si më poshtë:

Baztar në Ligjin Nr. 10405, datë 24.03.2011, për “Kompetencat për caktimin e pagave e të shpërblimeve”, nenin 54 pika ç të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pikën 17 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 165 datë 02.03.2016 për “Grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, ku citohet:

“Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore miratojnë pagën e punonjësve të njësive ekonomike dhe të insitucioneve të varësisë, me përjashtim të rasteve kur me ligj është parashikuar ndryshe” duke respektuar hierarkinë e pagave të nëpunësve apo punonjësve të bashkisë përkatëse”, në kuadër të ndryshimeve në legjislacionin e pagave si dhe të rritjes së nivelit të pagave në të gjitha institucioneve të varësisë të Bashkisë së Tiranës, propozojmë ndryshimet në nivelin e pagave të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve si dhe të Klubit Sportiv “Tirana”.

Këto ndryshime vijnë si domosdoshmëri e :

- Rritjes së pagës minimale në shkallë vendi
- Ndryshimeve në legjislacionin e pagave për pushtetin vendor (VKM nr.169 , datë 02.03.2016), si dhe vendimet e Këshillit të Ministrave për të gjitha institucionet qendrore dhe vendore.
- Rritjen e inflacionit.

Niveli i pagave për punonjësit e QEZHEF dhe të Sportiv “Tirana”, bazohet në pagën e grupit (diploma e shkollës), e cila lidhet ngushtësisht me nivelin arsimor, shtesa për vjetërsinë në punë e që është 2% për çdo vit pune mbi pagën e grupit dhe shtesën për funksion.

Vlera e pagës së grupit për diplomat e arsimit të lartë është e unifikuar sipas lidhjes nr.9 të VKM nr.169 , datë 02.03.2016.

Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve menaxhon 31 çerdhe në qytetin e Tiranës dhe përgjigjet për mirërritjen e fëmijëve përsa i përket programit mësimor, edukativ dhe ushqimin e fëmijëve në çerdhe si dhe nga janari 2016 ka ne administrim edhe kopshtet. Në këto kushte rritja e nivelit të pagave vjen si domosdoshëri e përafrimit të nivelit të pagave sidomos punonjësve që punojnë direkt në çerdhe, me pagat aktuale të kopshteve, të miratuara me VKM Mosaplikimi të rritjes së pagave (për shkak të inflacionit) gjatë viteve të fundit, krijon diferencime në paga midis institucioneve në varësi të Bashkisë së Tiranës, prandaj propozojmë që të kemi dhe një rritje në nivelin e pagave aktuale me qëllim motivimin e punonjësve dhe përafrimin e pagave të Insitucioneve tona me nivelet aktuale të pagave të Insitucioneve analoge me karakter qendror si më poshtë:

Lidhja nr.5

Niveli i pagave për punonjësit e Qendrës Ekonomike të Zhvillimit & Edukimit të Fëmijëve

Nr.	Pozicioni	Kategoria	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion
			1	2	3
1	Drejtor i Përgjithshëm	II-a	1	2%	105 000
2	Drejtor	II-b	1	2%	80 000
3	Pergjegjes sektori	III-a	1	2%	55 000
4	Pergjegjes sektori	III-a/1	1	2%	52 000
5	Specialist I	IV-a	1/2/3	2%	35 000
6	Specialist II	IV-b	1/2/3	2%	31 000
7	Pergjegjes çerdheje	IV-c	1/2/3/4	2%	30 000
8	Kujdestare	IV-c/1	1/2/3/4/5	2%	25 000
9	Specialist i mesem,furnitor, magazinier	IV-c/1	4	2%	25 000
10	Kuzhinierë	IV-c/2	4/5	2%	23 000
11	Shofer				30 000
12	Nd/kuzhinierë ,sanitare, pastrues, punëtor magazine				28 000
13	Roje				26 000

Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.5 të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË E TË MESËM E TETEVEJEÇAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e arsimit të lartë:	
1	Master i Shkencave Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë
4	Diplomë e arsimit të mesëm	8 000 lekë
5	Diplomë e arsimit tetëvjeçar	6 000 lekë

Lidhja nr.7

Niveli i pagave për punonjësit e Klubit Sporiv "Tirana"

Nr.	Pozicioni	Paga individuale			Paga mujore
		Kategoria	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion
			1	2	3
1	Drejtor Klubi	II-b	1	2%	80 000
2	Trainer	III-b	1/2	2%	47 000
3	Pergjegjes i Zyrës së Financës	IV-a	1/2/3	2%	37 000
4	Specialist, Llogaritar-arkëtar	IV-b	1/2/3	2%	34 000
5	Masazhator	IV-b	1/2/3/4	2%	34 000
6	Pergjegjes terrenesh	IV-c	4	2%	28 000
7	Shofer, magazinier				34 000
8	Punetor terrenesh				30 000

Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr. 7 të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË
LARTË E TË MESËM

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e arsimit të lartë:	
1	Master i Shkencave Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë
4	Diplomë e arsimit të mesëm	8 000 lekë

Aplikimi i pagës sipas lidhjeve të mësipërme do të fillojë nga data 1 Maj 2016 dhe efektet financiare të rritjes së pagave do të përballohen nga buxheti i këtyre institucioneve për vitin 2016.

Duke shpresuar në miratimin e këtij projekt-vendimi nga ana juaj,


Drilona Aliko 
Specialist i Sektorit të Asisitencës Ligjore dhe Legjislacionit

Arba Isaj 
Përgjegjës i Sektorit të Zbatimit të Buxhetit


Anisa Seferaj 
Drejtori i Drejtorisë Juridike

Jonida Halili 
Drejtor i Përgjithshëm i Menaxhimit Financiar

Itena Ndroqi 
Drejtor i Përgjithshëm Juridik i Aseteve dhe Licensimit

Keti Luarasi 
Drejtor i Përgjithshëm i Burimeve Njerëzore

Arbjan Mazniku
Zv. Kryetar

Arsela Gjonaj 
Juriste e Këshillit Bashkiak

Behar Zeneli
Sekretar i Këshillit Bashkiak